

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission in
Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies au
Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

TRANSKRIPT

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS,
TË MBAJTUR MË 15 JANAR 2004

PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA,
ODRŽANE 15. 01. 2004. GODINE

JANAR - JANUAR
2004



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

RENDI I DITËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Transportin rrugor (2003/32),
3. Shqyrtimi i Vendimit të panelit lidhur me mocionin e Koalicionit „Kthimi,, në Ligjin për Prokurimin publik nr.2003/17,
4. Përgjigjet në pyetjet e deputetëve,
5. Përgaditjet për rendin e ditës për Seancën plenare më 22 janar 2004:
 - 5.1 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Odën Ekonomike të Kosovës (2003/33),
 - 5.2 Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Tregti me naftë dhe derivetet e saja (2003/35),
 - 5.3 Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Kinematografi (2003/36).

ДНЕВНИ РЕД

1. Усвајање записника са претходне седнице,
2. Друго разматрање Нацрта закона о друмском саобраћају (2003/32),
3. Разматрање Одлуке Панела о моцији Коалиције „Повратак,, на Нацрт закона о јавној набавци бр.2003/17,
4. Одговори на посланичка питања.
5. Припреме за дневни ред пленарне седнице од 22 јануара 2004:
 - 5.1 Друго разматрање Нацрта закона о Привредној комори Косова (2003/33),
 - 5.2 Прво разматрање Нацрта закона о трговини нафтом и њеним дериватима (2003/35)
 - 5.3 Прво разматрање Нацрта закона о кинематографији (2003/36).



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

AGENDA

1. Approval of the minutes from the previous meeting,
2. Second reading of the Draft Law on Road (2003/33),
3. Review of the Panel Decision regarding to the motion of Coalition „Return” to the Law on Public Procurement nr.2003/17,
4. Responses on the deputies questions.
5. **Preparation of the Agenda for the Plenary Session on 22 January 2004:**
 - 5.1 Second reading of the Draft Law on the Chamber of Commerce of Kosovo (2003/33),
 - 5.2 First reading of the Draft Law on fuel trading and fuel products (2003/35),
 - 5.3 First reading of the Draft Law on Cinematography (2003/36).

TRANSKRIPT

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 15 JANAR 2004

Seanca plenare e Kuvendit të Kosovës u mbajt në sallën e Kuvendit të Komunës – Prishtinë.

Seancën e kryesoi Akademik Nexhat Daci, kryetar i Kuvendit të Kosovës.

Bashkëkryesues Fatmir Sejdiu, anëtar i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës.

Seanca plenare filloi punën në orën 10,00.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Mirëmëngjes të gjithëve.

Mirëseardhje në Seancën e parë të këtij viti.

Dhe, para se të fillojmë, më lejoni që t'ju përkujtoj, edhe pse të gjithë e ndjejmë dhe mbajmë mend me dhembje.

Seanca e parë plenare e vitit 2004 bjen në datën e masakrës së Reçakut – një ditë dhe datë të cilën e kujtojmë me dhembje dhe krenari.

Prandaj, në shenjë të rrespektit të kësaj date historike për Kosovën, në shenjë të rrespektit për ata që u masakruan dhe të dhembjes që e ndajmë me familjarët – ju lutem që me një minut heshtje t'i përkujtojmë.

L a v d i !

(Shumica e të pranishmëve në sallë): L a v d i !

Shpresoj që materialet për rendin e caktuar të ditës i keni marrë me kohë dhe mendoj se pa humbur kohë duhet të fillojmë me punën.

Nëse keni diç në emër të grupit... Urdhëroni. Zoti Gani Koci, në emër të Partisë Demokratike të Kosovës.

GANI KOCI:

Zoti kryetar, të nderuar kolegë deputetë,

Duke pasë parasysh faktin tashmë të njohur të përfoljes shumë të madhe rreth funksionimit të Kuvendit, administrimit dhe menaxhimit në përgjithësi të Kuvendit dhe duke pasë për bazë faktin që tash e pesë muaj ne sillemi si deputetë nëpër këto skuta, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës ia bën këto pyetje Kryesisë së Kuvendit dhe posaçërisht kryetarit të Kuvendit zotit Daci:

Pse është vonuar përfundimi i punimeve të sallës së Kuvendit?

Kur do të përfundojë ajo dhe kush është fajtor për moskryerjen me kohë të punëve?

Pse nuk ka pasë transparencë publike lidhur me tenderin rreth punëve të sallës së Kuvendit?

Kush e ka dhënë atë tender dhe cili organ e ka vlerësuar tenderin?

Sa është rrespektuar rregullorja 2001/19 edhe në tenderët e fundit dhe për tenderët e fundit?

A ka qenë Kryesia e Kuvendit e informuar për këto çështje?

Sa është e vërtetë që për tenderin për renovimin e Kuvendit të Kosovës juve, zoti Daci, ju janë dhënë mbi gjysmë milioni euro nga fituesi i tenderit?!

Për këto dhe për shumë të tjera, ne si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës - për t'i vërtetuar këto fakte, në emër të Grupit, propozojmë që konform Rregullores së punës të Kuvendit, Rregulla 38 pika 1 të formohet një komision hetues parlamentar i cili do të mirret me këto çështje të cilat u ngritën sot këtu.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike edhe në formë të shkruar ka bërë këtë mocion dhe do ta marrë me kohë Kryesia dhe kryetari, posaçërisht.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit shumë. Unë mendoj se është sihariqi i shkëlqyeshëm! E falënderoj shumë për dhuratën që komesarët politik e kanë filluar t'më ndajnë këtë vit.... t'më ndajnë medale të ndryshme. Nuk mendova në ju, zoti Koci - për komesar politik.

Unë mendoj se çdo gjë duhet të përgatitet, dhe mirë që e keni shtruar edhe si kërkesë për Kryesi. Meqë s'e kuptova, në qoftë se kërkonti që të hapet me procedurë të shpejtë - unë mund ta vë në votim kërkesën. Mirë, falemnderit. Do të thotë çdo gjë është e drejtë e deputetit dhe kjo është pyetje e deputetit. Jo e grupit parlamentar?

(Ndërhyhet prej vendit: E Grupit Parlamentar!).

Jo, por është pyetje që mund t'i... Prandaj, dakord jam plotësisht. Plotësisht jam dakord që krejt kjo që kërkuat ju le të shkruhet, le të përgatitet profesionalisht dhe le t'iu ndahet të gjithë deputetëve – të gjithë deputetëve. Dhe, ata që kërkojnë – ata që kërkojnë - besoj se duhet t'i ndiejnë pasojat e një propagande të egër – të egër – të egër politike. Dhe, në qoftë se ka çdo gjë të vërtetë ose diçka - diçka më së paku të vërtetë të kësaj – pasojat duhet t'i bartë ai që i drejtohet në maksimumin e palejueshëm juridik, politik dhe moral.

Prandaj, përfundojeni – përfundojeni që komisarët politik të bunkereve të bëhen edhe prokurorë edhe gjithçka – nëpër media. Kjo nuk i dedikohet Grupit parlamentar. Atë që e kam unë, e them gjithmonë shumë qartë, shumë haptas dhe pa ekuivoke. Unë thash, në qoftë se është kërkesë.... Juve s'ju dedikohet përgjigja, prandaj thash në qoftë se kërkonti me procedurë të shpejtë – e qesim në votim. Unë jam dakord.

DRAGIŠA KRSTOVIĆ:

Gospodine predsedniče, dame i gospodo poslanici,

Zamolio bih da u buduće ne pravimo situacije kao što je napravljena na početku ove sednice. Bez obzira na to da li te žrtve zaslužuju ili ne zaslužuju odavanje počasti, u šta se ne upuštam i ne želim to pitanje da komentarišem jer nisam ni kompetentan da o tome raspravljam, ali ovakva situacija stvara svakako jednu ružnu i neprijatnu sliku da jedan deo sale odaje počast a drugi je zbunjen i ne zna kakav je cilj ovoga.

Mislim - zbilja nije u redu. Ja vas razumem i, ovaj, ne ljutim se što se ljutite. To je vaše pravo. Dozvolite, ja sam izašao za govornicu da to svoje demokratsko

pravo iskoristim... Ja ću vam reći iskreno – osetio sam da se nešto priprema, što treba da napravi neku čudnu situaciju! Tamo - iza tog stuba - je bilo nekih dogovora, kao što je bilo i na predzadnjoj sednici dogovora oko toga da treba zabraniti izbore za Skupštinu Srbije, umesto da predsednik pozove šefa poslaničke grupe i da mu otvoreno kaže – imamo nameru da to ide na dnevni red - izvolite, zauzmite svoj stav, i tako dalje. To nije ništa strašno. Kao što smo i prošlom prilikom mogli da se dogovorimo..., zapravo da razgovaramo oko toga da ova Skupština ima nameru da potegne pitanje legitimnosti izbora za Skupštinu Republike Srbije na ovom prostoru i da se to saopšti šefu poslaničke grupe i da šef poslaničke grupe to zna i da poslanička grupa u vezi s tim ima stav, i da sve bude u redu. O tome toliko.

A ja bih predložio da se druga tačka dnevnoga reda odloži za sledeće zasedanje, iz tog razloga što je Poslanička grupa Koalicije «Povratak» imala amandmane koje je na ovaj Nacrt zakona podnela 9. januara ove godine, po tumačenju stručne službe - najverovatnije sa zakašnjenjem odnosno po isteku onog roka koji je Poslovníkom predviđen. Moje stanovište je nešto drugo i mislim da bi bio red da se... ili postoji mogućnost da se napravi kompromisno jedno rešenje i da se ovo pitanje... da se rasprava po ovom Nacrtu zakona odloži a da se uzmu u obzir... u obzir amandmani koja je podnela Poslanička grupa Koalicije «Povratak».

Znači, predlažem da se ovo pitanje odloži... I još jedan razlog za odlaganje. Dnevni red je danas utvrdjen. Predlog dnevnog reda je utvrdjen na Predsedništvu Skupštine od 13. ovog meseca, dakle samo dva dana pre zasedanja. Svi poslanici o dnevnom redu nisu bili obavesteni i ako su najranije mogli da budu obavesteni to je dva dana. Za dva dana nisu mogli da se pripreme kvalitetno da učestvuju u raspravi po pitanjima koja su na dnevnom redu. Hvala.

KRYETARI I KUVENDIT:

Unë do t'i lejoj edhe të gjithë udhëheqësit e grupeve parlamentare. Vetëm unë mendova që zoti Dragisha Kërstoviq po del vërtet me e lavdërue atë gjest si gjest të shkëputjes ndaj një politike gjenocidale që ka kaluar dhe mendoj që deputetët e këtij Parlamenti duhet të gjithë masakrat t'i ndejnë thellë, por është çështje e gjithëkujt.

Për këtë të dytën, Parlamenti duhet të informohet drejt që vërejtjet ose amendamentet që Dragisha i përmendi kanë ardhur pas kohe. Do të thotë - pas afatit të caktuar. Një herë në Kryesi, me konsensus, e kemi lejuar futjen e një kërkesë të "Povratakut" si shenjë solidarizimi dhe shenjë dëshire për bashkëpunim dhe qasje inkluzive në punë, por i kemi thënë se kjo është e fundit.

Unë mendova që po të ishin arsyeat që janë dorëzuar vonë dhe Grupi nuk ka pasë kohë në mënyrë cilësore me i shqyrtuar dhe me kontribue në punë, atëherë do t'iu kisha bashkëngjitur.

Zoti Dugolli ka kërkuar fjalën në emër të Aleancës.

BUJAR DUGOLLI:

Zoti kryetar, të nderuar deputetë,

Grupi ynë Parlamentar ka kërkuar që në seancën e fundit të vitit të kaluar qëkur është hartuar Deklarata mbi zgjedhjet serbe që parashiheshin të mbaheshin në Kosovë të futet edhe çështja e deputetëve të këtij Kuvendi të cilët kanë kandiduar për parlamentin e Serbisë.

Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës kërkoj që këtyre deputetëve, si të Partisë Radikale Serbe, Socialiste apo tjerat nga ky Kuvend që kanë kandiduar për zgjedhje të Serbisë t'iu mirret mandati. Këta nuk mund të luajnë rol të dyfisht. Po të ishin zgjedhur do të ishim në pozita të njëjta që të kërkonim dhe unë mendoj se nuk ka nevojë argumente më të mëdha se që këta po tregojnë vetë sa destruktivë janë në punën e tyre dhe propozoj që kjo çështje të shqyrtohet dhe t'u mirret mandati si deputetë të Kuvendit të Kosovës. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Unë mendoj se nuk është çështje e ngutshme. Le të mirret seriozisht e le të shqyrtohet kjo çështje, por nuk bjen në çështje të ngutshme dhe aq më tepër nuk besoj se ndonjë deputet... sepse nuk ka rezultate. Megjithatë do të h yjë në procedurë të rregullt, zoti Dugolli dhe do t'i shqyrtojmë të gjitha mundësitë juridike dhe profesionale.

Për çështjen e shtyrjes të kësaj pike të rendit të ditës, vetëm po dua me ju konsultue. Në qoftë se edhe ndonjë grup parlamentar mendon që mund t'ketë hapësirë për cilësi pune, unë do ta pyetja seancën... Do të thotë, varet prej grupeve parlamentare. Ne jemi të përgatitur të punojmë.

Prandaj, vazhdojmë me rendin e ditës:

- Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Vetëm shefat e grupeve parlamentare mund të lejohen të paraqiten.

A ka vërejtje në Procesverbal?

Atëherë, nëse ka ndokush vërejtje në Procesverbal të mbledhjes së kaluar, ato le të bëhen me shkrim, si gjithmonë, në qoftë se e sheh të arsyeshme.

Të procedojmë më tej, ju lutem.

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për transportin rrugor.

Projektligji është miratuar në parim më 20 nëntor 2003.

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar dhe Kuvendit i kanë bërë rekomandime, si vijon:

1. Komisioni për gjyqësi, legjislacion dhe kornizë kushtetuese, ka vlerësuar se Projektligji ka bazueshmërinë në Kornizën kushtetuese.
2. Komisioni për buxhet, ka vlerësuar se Projektligji nuk përmban implikime financiare dhe buxhetore.
3. Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve ka vlerësuar se me këtë ligj nuk cenohen të drejtat e komuniteteve, dhe
4. Komisioni për transport dhe telekomunikacion, si Komision funksional dhe referues, Kuvendit i ka paraqitur rekomandime me amendamente.

Këtë e tha edhe zoti Dragisha. Grupi Parlamentar i Koalicionit "Kthimi" ka dorëzuar amendamentet në këtë Projektligj jashtë afatit të paraparë me Rregullën 29 të Rregullores së punës të Kuvendit.

E ka fjalën edhe një herë Dragisha, si shef i Grupit Parlamentar.

DRAGIŠA KRSTOVIĆ:

Gospodine predsedniče, dame i gospodo poslanici,

Dnevni red, po kojem se radi, nije utvrđen po važećem Poslovniku. Ovo što je Predsedništvo dalo predlog od 13. ovog meseca je predlog, a dnevni red nije usvojen. Dakle, nije bilo dizanje ruku da se dnevni red prihvati... predlog dnevnog reda prihvati ili odbije. Ovo je povreda Poslovnika i ja molim da se to tamo gde treba konstatuje.

A što se tiče Nacrta zakona o drumskom prevozu moje je mišljenje i mišljenje Poslaničke grupe Koalicije «Povratak» je da ovaj zakon nije u skladu sa Rezolucijom Saveta bezbednosti Ujedinjenih nacija 1244.

Rezolucija u mnogim svojim odredbama, negde sasvim jasno i precizno, negde manje jasnije – konstatuje da se na Kosovu organizuje privremena uprava pod kojom svi ljudi na Kosovu mogu uživati značajnu autonomiju u okviru SRJ. To piše! Svako od nas ima Rezoluciju. To je pitanje koje je de jure takvo. De fakto je nešto možda drugačije, ali ovo je nešto što je jedan Ustavni okvir... Ne verujem da to zaslužuje nikakav smeh i ova moja priča, ali šta je - tu je.

Nacrt zakona o drumskom prevozu, u brojnim svojim odredbama, pokušava da izadje iz okvira ove Rezolucije, pa su takvi – na primer član 3. Nacrta, član 4. tačka 3., član 9. tačka 1., član 9. tačka 2., član 11. tačka 3., član 15., član 18. tačka 2. pod c) i tako dalje, i tako dalje - koji teritoriju Državne Zajednice Srbije i Crne Gore kao sukcesora, kao pravnog sukcesora SRJ - definišu kao stranu teritoriju odnosno drugu zemlju, i tako prejudiciraju konačni status Kosova.

Amandmani Funkcionalne komisije se ne odnose na ove odredbe Nacrta zakona i ni na koji način ne popravljaju postojeći tekst Nacrta zakona i ovim pitanjima se ne bave. Ja razumem da što je to tako.

Koalicija «Povratak» je predala svoje amandmane na ovaj Nacrt zakona 9. 1. 2004. kako sam maločas rekao. Oni nisu ušli u proceduru. Pravilo 28. stav 1. Privremenog poslovnika kaže zaista da će u proceduru ući oni sadržajni predlozi i oni sadržajni amandmani koji se predaju na pet radnih dana pre početka rasprave... pre rasprave o tom predlogu. Eh sad – da li je to sednica Skupštine kao početak raspravu o tom predlogu, ili je to sednica neke komisije koja je počela da raspravlja o tom predlogu, ili se taj rok od pet radnih dana može tumačiti i na drugi način – to je pitanje o kojem ćemo mi verovatno tražiti da se raspravi na odgovarajuće mesto.

Dnevni red je utvrđen po pravilu člana 19., zapravo predložen. Danas je, po mom mišljenju, prekršen Poslovník zato što dnevni red nije usvojen a po njemu se radi. Za današnje zasedanje dakle taj predlog je poteko na sednici Predsedništva od 13.1.2004. godine. Mislim da o dnevnom redu nisu konsultovane poslaničke grupe. Poslanička grupa Koalicije «Povratak» sigurno nije konsultovana a postoji obaveza Predsedništva da povodom utvrđivanja dnevnog reda konsultuje sve poslaničke grupe pa prema tome i Poslaničku grupu Koalicije «Povratak» - to je Pravilo Poslovníka 19. tačka 3. I ja zbog toga predlažem da jedan kompromisni predlog i dalje, i molim skupštinsku većinu da se ovaj zakon danas odbije jer je u sigurnoj nesaglasnosti sa Rezolucijom. Dobro, ovaj... Mi ćemo upotrebiti sva ona demokratska sredstva na koje imamo pravo po Ustavnom okviru, po rezoluciji, po Poslovníku i po drugim propisima...

KRYETARI I KUVENDIT:

Dragisha, shkurtoje se koha të ka kaluar. Urdhoro...

DRAGIŠA KRSTOVIĆ:

Evo samo... Evo završavam predsedniče, završavam! Ovaj, predlažem dakle da se zakon odbije i da se odredi treće čitanje zakona po Poslovníku... Pa nisam nikoga, eh... koje pravilo sadržano u odredbi člana 34. Poslovníka. U protivnom mi ćemo, naravno, primeniti sve ono što po Ustavnom okviru i Poslovníku imamo pravo.

Mislim da bi ovo bio jedan vrlo korektan izlaz iz situacije u kojoj se sada nalazimo i mislim da je mogućnost za kompromis apsolutno očigledna. Hvala.

KRYETARI I KUVENDIT:

Një moment. Unë për hirë të procesverbalit... E vetmja vërejtje në rend dite ishte nga Koalicioni "Kthimi" dhe nuk gjeti përkrahje. Logjikisht rendi i ditës është aprovuar. Unë e falënderoj Dragishën se vërtetë e kam shkelë rregullën e punës tash duke ia dhënë fjalën për atë, sepse në fazën e aprovimit të amendamenteve nuk e ka këtë në mundësi. Prandaj për këtë vërejtje unë do të korrigjohem dhe nuk do ta prishi më apo shkeli rregulloren.

E ka fjalën zoti Sabri Hamiti, shef i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike.

SABRI HAMITI:

Zotni kryetar, kolegë të nderuar,

Janë bërë pak si modë këtu që të flitet pa kurrfarë peshe të fjalës për problemet edhe në kohët kur bisedohet krejt për probleme tjera.

Parafolësi im dëshmoi edhe një herë që ky Grup Parlamentar është grup i lazduar. Ky Grup Parlamentar është grup i papërgjegjshëm. Ky Grup Parlamentar është grup me mandate të falura, prandaj s'ka kurrfarë përgjegjësie as ndaj këtij Kuvendi as ndaj zgjedhësve të vetë.

U pa definitivisht edhe sot, qysh është pa qe dy vjet, që është një dizajnim i paarsyeshëm i Kuvendit të Kosovës, duke falë mandate.

Herë në tipin e diskurseve politike të tejkalueme, herë në tipin e lojës t'procedurave të Kuvendit ne kemi një obstrukcion total të punës të Kuvendit dhe ne e dijme që ky Grup deri sot s'e ka votuar asnjë ligj, bile s'i ka votuar as deklaratat për kthimin e të të shpërngulurve. Thjeshtë, shkurt e shqip – e ka pranue botnisht misionin e politikës destruktive të Beogradit në Kuvendin e Kosovës dhe kjo duhet të dihet e t' thuhet publikisht. Dhe, le të dihet që - nëse ato zgjedhje i orgnaizojmë në mënyrë demokratike në të ardhshmen - nuk do të falen mandate.

Pas caktimit të rendit të ditës t'punohet me rendin e ditës. Ndërsa, le t'ju mbetet në moralin e tyre - nëse kanë moral - që iu pengon pse dikush çohet të nderojë viktimat. Ndoshta e kanë problem personal pse s'mund të çohen, sepse e kanë fajin pas veshit t'vogël. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Replikë, një minut.

DRAGIŠA KRSTOVIĆ:

Mislim, gospodine predsedniče, da je vaša obaveza po Poslovniku da ovakve napade prema jednoj poslaničkoj grupi sprečite, ili da izreknete bilo kakvu opomenu. Ja nikoga, i zaista – nikoga, ni kao entitet politički, ni pojedinačno nisam pomenuo. Ja imam pravo, kao poslanik Poslaničke grupe Koalicije «Povratak», kao poslanik jedne zajednice koja živi na Kosovu da kažem u ime te

zajednice ono što je interes te zajednice. Mislím da sam taj interes formulísaó na najbolji mogući naćin prema mojim sposobnostima i zaista ne vidim nijedan jedini razlog da ovako budemo optuživani za nešto na šta imamo pravo po Ustavnom okviru i po važećim propisima. Hvala.

KRYETARI I KUVENDIT:

Po, po replikë, urdhëroni.

SABRI HAMITI:

T'folunit të dytë t'zotniut është alternativ, por unë e dii këtë metodë të t'folunit alternativ prej nalt – poshtë. Sido që të jetë, mos t'harron se çdo gjë që flitet dhe thuhet këtu edhe shkruhet. Është hera - jo e parë, por është hera e tretë që zotniu del në foltore dhe flet në stilin e hetuesve të këtynehershëm të UDB-ës qysh i përcjell njerëzit kush me kend flet. Nëse ai e ka funksionin që t'i përcjellë njerëzit kush me kend flet, e ka gabuar vendin dhe e ka gabuar kohën. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Vazhdojmë me amendamentet:

Amendamenti 1, Komisioni funksional.

Kjo nënkupton se të gjitha komisionet tjera relevante e kanë përkrahur.

Kush është për këtë propozim? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Ju falemnderit.

A ka abstenime?

Nuk ka abstenime, 12 vota kundër – kalon amendamenti.

Amendamenti 2, Komisioni funksional.

Kush është për? Ju falemnderit.

Kush është kundër?

A ka votë abstenimi?

Nuk ka abstenime, 13 vota kundër – kalon amendamenti.

Amendamenti 3, Komisioni funksional.

Kush është për?

A, vërejtje keni? Komisioni ka vërejtje. Më falni ju lutem. Unë mendova se janë harmonizuar ...

HAKI SHATRI:

Të falemnderit zoti kryetar.

Nuk ju kisha marrë kohë dhe me ju munduar, por meqenëse mënyra e paraqitjes së qëndrimeve të Komisionit kanë ndërrue, e atje shkruan në fund se qëndrimin e Komisionit duhet ta prezentojë personi i caktuar për këtë – në këtë rast Komisioni më ka caktuar mua që të shpreh qëndrimin e Komisionit për buxhet lidhur me amandamentin numër 3.

Komisioni për buxhet amendamentin numër 3 nuk e ka përkrahur, jo për arsye se ka implikime buxhetore, por pas sqarimeve me ekspertët e kësaj lëmie jemi bindur se fjala është për kompetenca profesionale e jo për kualifikim profesional. Dhe, ky qëndrim, mendoj është edhe qëndrim i Grupit Parlamentar të LDK sepse jemi pajtuar dhe bindë se është ashtu.

Meqenëse dola, e për mos me dalë edhe një herë, po ju them se Komisioni për buxhet nuk e ka përkrahë edhe pjesën e dytë të amendamentit numër 8 lidhur me nenin 45 pikë 2. Në atë amendament kërkohet që ekskluzivisht biletat udhëtarët mund t'i marrin vetëm në stacion të autobusit dhe askund tjetër. Ne mendojmë se ajo nuk është e arsyeshme, prandaj nuk është përkrahur ky gjysmë amendamenti dhe ky është edhe qëndrim i Grupit Parlamentar të LDK. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. A mos deshët, ju Grupi Parlamentar...? Më falni.

Atëherë, kush është për amendamentin 3, kështu siç është dhënë?

Po, në emër të Komisionit, keni të drejtë me Rregullore.

QAZIM KABASHI:

I nderuari kryetar, të nderuar kolegë,

Vërejtja e Komisionit për buxhet në nenin 3 – në amendamentin 3 qëndron. Por, meqenëse kjo ka qenë e paraparë në ligj, pra vetëm anulohet dhe mbetet siç është në ligj. Anulohet do të thotë amendamenti 3 dhe mbetet si është në ligj. Hiqet.

Kurse në amendamentin 8, pjesa e dytë, është e drejtë – e përkrahim. Që të mos dalë dy herë.

KRYETARI I KUVENDIT:

Prandaj, në fakt, amendamenti 3 është inekzistent dhe hiqet. Ju falemnderit.

Unë dua ta qes në votë dhe ta rrespektoj procedurën.

Kush është për amendamentin 3, kështu siç është paraqitur? Një. Ju falemnderit.

Do të thotë hiqet dhe mbetet ashtu siç ka qenë në ligj.

Amendamenti 4, Komisioni funksional.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Ju falemnderit.

A ka abstenime?

Nuk ka abstenime, 13 vota kundër – kalon amendamenti 4.

Amendamenti 5, Komisioni funksional.

Kush është për? Ju falemnderit.

Kush është kundër?

A ka abstenime?

Nuk ka abstenime, 13 vota kundër – kalon amendamenti.

Amendamenti 6, Komisioni funksional.

Kush është për? Ju falemnderit.

Kush është kundër?

A abstenon kush?

Nuk ka abstenime, 13 vota kundër – kalon amendamenti.

Amendamenti 7, Komisioni funksional.

Kush është për?

A ka votë kundër?

A ka abstenime?

Nuk ka abstenime, 13 vota kundër – kalon amendamenti.

Amendamenti 8, Komisioni funksional.

Kush është për?

Urdhëroni...Jo, unë mendova kush është me atë përmirësim.

SABRI HAMITI:

Jo, jo, por po na ndodhin hutime n'votime që janë qesharake nganjëherë.

Amendamenti 8, Komisioni funksional deri tash ka ardhur me këto dy varianta. Mirëpo, Komisioni i buxhetit e ka kontestuar pjesën e dytë të këtij amendamenti – 45.2 të cilin tash po e pranon edhe Komisioni paraprak.

Unë që s'pari kujtoj të dy komisionet dhe po ju them, në emër të Grupit Parlamentar të LDK që ne do të votojmë që kjo pjesa e dytë të mos votohet, por po pjesa e parë. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Unë mendova që e kuptuan deputetët. Prandaj, votojmë sepse u harmonizuan të dy komisionet dhe votojmë për pjesën unike.

Kush është për këtë mënyrën qysh u pajtuan komisionet, do të thotë të aprovohet pjesa e parë – pjesa e dytë nuk aprovohet? Ju falemnderit.

Kush është kundër?

A ka abstenime? Një.

Një abstenim, 13 vota kundër – kalon amendamenti – pjesa e parë.

Amendamenti 9, Komisioni funksional.

Kush është për? Ju falemnderit.

Kush është kundër?

A ka abstenime?

Nuk ka abstenime, 13 vota kundër – kalon amendamenti.

Amendamenti 10, Komisioni funksional.

Kush është për?

Kush është kundër?

A ka abstenime?

12 vota kundër, nuk ka abstenime – kalon amendamenti.

Amendamenti 11, Komisioni funksional.

Kush është për? Ju falemnderit.

Kush është kundër?

A ka abstenime?

Nuk ka abstenime, 13 vota kundër – kalon amendamenti.

Amendamenti 12, Komisioni funksional.

Kush është për? Ju falemnderit.

Kush është kundër?

A ka abstenime?

Nuk ka abstenime, 12 vota kundër – kalon amendamenti.

Në fund, ju lutem – kush është për aprovimin e Ligjit të amendamentuar kësisoj?
Ju falemnderit.

A ka votë kundër? 12 kundër.

A ka abstenime? Nuk ka abstenime.

Konstatohet se ligji është aprovuar. 96 deputetë janë të pranishëm në sallë.

Ju falemnderit shumë.

(Duartrokitje)

Votimi – Glasanje – Voted:

- Për – Za – ForShumica – Vecina – Majority.....
- Kundër – Protiv – Against12.....
- Abstenime – Uzdržani – Abstained.....00.....

Pika vijuese është:

- Shqyrtimi i Vendimit të panelit lidhur me mocionin e Koalicionit “Kthimi” në ligjin për prokurim publik.

Materiali iu është shpërndarë deputetëve me kohë dhe në mënyrë të duhur.

Hydajet nuk ka nevojë për diskutim?

Ju, në emër të grupit po. Urdhëroni.

BUJAR DUGOLLI:

Të falemnderit kryetar.

Të nderuar deputetë, rreth kësaj dukurie të mocioneve pa bazë, unë dëshiroj t’i jap disa qëndrime të Grupit Parlamentar të Aleancës.

Në rend të parë – kërkesë për Kryesinë e Kuvendit - që të mos pranojë asnjë mocion pas kalimit të afatit prej 48 orësh siç është e paraparë me Kornizë.

Nën 2. Kërkojmë nga Qeveria e Kosovës që, në rast se formohen këto panele, të dërgojnë njerëz kompetent për të dhënë vlerësimin profesional në këto mocione që bëhen.

Nën 3. Kërkojmë nga Komisioni për legjislacion dhe kornizë kushtetuese të punojë në ndryshimin e nenit 9 pika 1, pikë 39, 40, 41 dhe 42.

Dhe, kërkojmë nga UNMIK-u që të mosë i marrë për bazë shantazhet – destruksionin që e bëjnë disa deputetë të papërgjegjshëm nga Koalicioni “Kthimi” që kanë për qëllim të bëjnë sabotazhë në punën e Kuvendit që të mos aprovohet asnjë ligj.

Këto sabotazhe janë duke i kushtuar punës së Kuvendit dhe vetë neve – si deputetë, sepse kemi rastin kur ligjet nuk po nënshkruhen. Dhe, vetëm kohëve të fundit Ligji për regjistrimin e popullsisë që qëllimisht nuk është duke u nënshkruar, dhe vetëm për t’ia bërë qefin disa ekstremistëve nga partia e Sheshelit apo e Millosheviqit, vijnë pa kurrfarë baze juridike e thonë se iu janë cenuar të drejtat dhe interesat e komunitetit.

Dhe, kërkojmë nga Komisioni i Kornizës kushtetuese që në rast se Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve përkrahë ligjin, të mos pranohen forma tjera të prolongimit të nënshkrimeve të ligjeve.

Mosnënshkrimi i Ligjit për prokurim po ia gjatë jetën korrupsionit dhe devijimeve që mund të jenë në aspektet e kontratave dhe çështjeve tjera.

Mosnënshkrimi i Ligjit për regjistrimin e popullsisë po i kushton të gjithë Qeverisë dhe të gjithë institucioneve në hartimin e politikave për zhvillimin e përgjithshëm në Kosovë.

Prandaj, këtë çështje, këtë dukuri ne duhet ta ndalim dhe të mos mbetemi peng e disa individëve të papërgjegjshëm që pa kurrfarë baze juridike i bëjnë pengesë punës së Kuvendit. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Zoti Hydajet Hyseni, në emër të Grupit Parlamentar.

HYDAJET HYSENI:

Zoti kryetar, kolegë deputetë,

Thonë - nuk ka mënyrë më të mirë për të diskredituar diçka drejt - se sa të çohet deri në absurd. Unë e konsideroj të drejtë instrumentin e panelit për të mbrojtur interesat e drejta të komuniteteve kur ato rrezikohen. Por, në praktikën tonë, vërtetë ky instrument po keqpëdroret dhe po çohet deri në absurd. Po krijohet presedan pa presedan.

Me Kornizën kushtetuese, Rregulla 9.1.39 thuhet: – Deputetët mund të paraqesin mocion me shpjegim të arsyeshëm – të arsyetuar më falni, se ligji ose dispozitat e tij shkelin interesat jetike të një komuniteti, se ligji ose dispozitat e tij diskriminojnë një komunitet dhe cenojnë të drejtat e komunitetit ose të anëtarëve të tij, të drejta të parapara me Kreun 3 dhe 4, dhe që seriozisht

vështirësojnë mundësinë e komunitetit për mbrojtjen dhe shprehjen e identitetit etnik, kulturor, fetar e gjuhësor.

Në tekstin e propozuar nga paneli, përveç amendamentit 3 pika a) dhe b) i cili mund të konsiderohet i bazuar dhe do të duhej të ishte i mbështetur qysh në shqyrtimin e rregullt të Ligjit, amendamentet tjera s'kanë asnjë lidhje me komunitetet dhe me të drejtat e tyre.

Paneli s'mund të shndërrohet në një kujdestar të mangësive eventuale profesionale, terminologjike e tjera.

Për më tepër, në tekstin e propozuar, duke kërkuar saktësi të tilla, vëni re formulimin në të cilin kërkohet që tenderët të jenë të botuar – si thuhet: “njëlloj të jenë identik”. Në gjuhën shqipe thuhet “njëlloj identik”, kurse në gjuhën serbe dhe angleze “njëlloj autentik”. Kërkohet që aty të jenë, do të thotë “njëlloj” dhe në fakt, në tekstin që ka krejt tre amendamente megjithatë “bëhet një shkelje e rëndë”, nuk mund të kuptohet. Për më tepër, edhe në shqip, edhe në serbisht, edhe në anglisht ato nuk kanë asnjë kuptim sepse është gjë elementare e njohur e çdo dispozite, e çdo rregulle, sepse nëse bëhet në gjuhë të ndryshme duhet të jetë identike. Prandaj, formulimet e tilla nuk janë ligjore, nuk kanë të bëjnë me komunitetet dhe nuk duhet të kenë vend fare në procedura tona.

Është edhe një vërejtje tjetër formalo-juridike që u përmend, por mendoj se do duhej sqaruar më shumë. Edhe në këtë panel, po edhe në panelet tjera më parë – anëtarë të panelit janë: një Gjon Tajd, që s'e di çfarë funksioni ka. Vetëm thotë se është emëruar nga Përfaqësuesi Special. Një tjetër që është i emëruar nga sponsorizuesi, do të thotë nga ministritë, sepse janë disa ministri. Dhe është një Nenat Trifunoviq, i cili nuk është deputet.

Është rregull e Parlamentit tonë, por edhe e çdo parlamenti tjetër: amendamente mund të bëjnë vetëm deputetët dhe ministrat, por jo administratorët. Për më tepër, bëhen amendamente jashtë kërkesës së komisionit ose grupit që e ka kontestuar ligjin dhe bëhen amendamente pa rrespektuar procedurat. Nuk ka mundësi, ta zëmë Komisioni për buxhet ose komisionet profesionale, komisioni i ligjeve t'i shqyrtojë ato. Dhe, në këtë mënyrë ne po krijojmë një praktikë tjetër të shqyrtimit të ligjeve dhe të ndryshimit të ligjeve dhe për këtë është tërhequr vërejtja se në këtë mënyrë po e rrenojmë sistemin ligjvënës në Kosovë.

Prandaj, unë propozoj që Kuvendi të aprovojë amendamentin 3, neni 40 – 3 a) dhe b) që kërkon – për ata që nuk janë të informuar – që teksti i tenderëve të botohet në dy gjuhët dhe të jetë i botuar edhe në gazetën me tirazh më të madh në gjuhën serbe, kurse amendamentet tjera të refuzohen për arsyet që u theksuan më parë.

Shfrytëzohet rastin të kërkoj, po ashtu siç u kërkuar nga përfaqësuesi i Aleancës, që në të ardhmen në panel të mos lejohen që të bëjnë amendamente ata që nuk e kanë të drejtën për të bërë amendamente dhe nëse kjo ndodhë – unë i propozoj Kuvendit që të mos i shqyrtoj fare amendamentet e tilla.

Dhe tre, i kërkoj Përfaqësuesit Special që, nëse ka raste kur mendon se duhet t'i propozojë panel Kuvendit, atëherë të vijë ai ose përfaqësuesi i tij dhe ta shpjegojë tekstin e tij e ta bindë këtë Kuvend pse duhet të votojë diçka; pse duhet të ndryshojë diçka, e tjera. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Unë e kam një lutje. Kam vazhdimisht probleme me Partinë Demokratike të Kosovës. Shefi i Grupit Parlamentar është gjallë, shëndosh e mirë në sallë. Dhe, meqë unë vazhdimisht po hutohem, do të ishte mirë që në fillim të seancës me ma bë kërkesën dhe le ta dijmë kush dhe në emrin e kujt po del. Duhet me pyet... Unë do të doja që anëtarët e Kryesisë mos me dalë në emër të grupeve parlamentare, sepse e kanë shfrytëzuar të drejtën e vet në Kryesi. Ulu, Hydajet, s'ke nevojë për replikë!

Prandaj, ju lutem këto çështje janë ngritur në Kryesi dhe dy të parët, që i tha Bujari – ne po veprojmë sipas asaj dhe është lutur Qeveria me propozim dhënë anëtarit të Kryesisë që në panel të caktohen profesionistët më të mirë që i ka sponsori i ligjit dhe t'i zgjedhë ata.

Ju lutem, më s'kemi debate. Në parim po ju them, unë jam munduar me u konsultue me juristë dhe njerëz. Paneli nuk mund të ndahet. Nuk mund të ndahet e një pjesë ta votojmë dhe një pjesë mos ta votojmë. Vetëm po ju tërheq vëmendjen, e drejtë e deputetit dhe e Kuvendit është të votojë sipas ndërgjegjes së vetë. Por, pragmatizmi tregon që ligji do të nënshkruhet me panelin sepse panelin e kanë nënshkruar tre pjesëmarrës: sponsori i ligjit, kundërshtuesi i ligjit dhe njeriu që e ka caktuar personi i autorizuar. Dhe kjo nënkupton që çdogjë duhet të jetë në rregull kur janë tre vetë, sipas ligjit të autorizuar.

Unë do të them dhe do ta mbaj një qëndrim, sepse unë në Kryesi e krahasova dhe unë e kuptoj si vendim të Gjykatës Supreme në një mënyrë panelin. Unë do të votoj për panelin në parim, por e drejtë e deputetit është dhe e Kuvendit të përcaktohet si mendon. Profesor e di mendimin... ose urdhëro por mos ta zgjasim dhe komplikojmë, ju lutem.

Kush është për vendimet e panelit? Ju falemnderit shumë. Shumica absolute.

Kush është kundër? Numëroni votat kundër. Ju falemnderit.

A ka abstenime?

96 deputetë janë të pranishëm në sallë: 2 abstenime, 29 vota kundër – konsideroj se paneli është aprovuar.

(Prej vendit: Sa janë për? Tregoje sa është numri!)

Urdhëro? Të gjithë tjerët prej 96-tëve!

Votimi – Glasanje – Voted:

- Për – Za – ForShumica – Vecina – Majority.....
 - Kundër – Protiv – Against29.....
 - Abstenime – Uzdržani – Abstained.....02.....
-

Prej këtu, Seancën e udhëheqë bashkëkryesuesi Fatmir Sejdiu, anëtar i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës

BASHKËKRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës:

- Përgjigjet në pyetjet e deputetëve.

Nga Sekretaria është konfirmuar se kemi përgjegje gojore të ministreshës Resmie Mumxhiu në pyetjet e deputetëve Ismajl Kurteshi dhe Ramadan Kelmendi.

Ju lutem, e keni fjalën.

RESMIJE MUMXHIU:

I nderuari kryesues, të nderuar deputetë, pyetjet i keni përpara dhe do t'mundohem përgjigjen me dhënë.

Para një muaji spitali regjional në Mitrovicë ka vendosur që në bashkëpunim me ASHQ dhe përkrahje të Ministrisë të bërë një pjesë të shërbimeve spitalore në objektin e spitalit Sheik Zeit në Vushtrri. Kjo është bërë për të dëmtuar funksionet normale të shërbimeve ambulatorike në Mitrovicë. Në fillim kjo është bërë nga reparti i kirurgjisë me plan që në të ardhmen edhe disa reparte tjera, për shembull transfuzioni varësisht nga zhvillimi i ngjarjeve të bartë aktivitetet atje. Mirëpo, kjo është bërë për një periudhë të përkohshme dhe për disa arsye: shfrytëzimi i objektit që i ofron kushtet më të mira të punës; angazhimi i stafit profesional të shërbimeve të nivelit për të cilat janë përgatitur – mbi të gjitha ofrimi i kujdesit shëndetësor sekondar cilësor popullatës së regjionit. Gjithmonë të vetëdijshëm se kjo nuk është zgjidhja më e mirë dhe zëvendësim për spitalin regjional të Mitrovicës së veriut që padrejtësisht nuk administrohet nga ana jonë por kjo është zgjidhja edhe më e mirë për momentin.

Në këtë kontest pyetjet e deputetit Ramadan Kelmendi – sepse është mbyllur reparti i kirurgjisë në Mitrovicë nuk qëndron. I njëjti repart funksionon normalisht, ndërsa shërbimet 24 orëshe janë bartur përkohësisht në spitalin Sheik Zait në Vushtrri me qëllim të ofrimit të shërbimeve më të mira popullatës së regjionit. Kjo ishte pyetja e Ramadan Kelmendit.

A mundem me vazhdue menjëherë me pyetjen e dytë.

Ndërsa, sa i përket pyetjes së Ismajl Kurteshit që në ambulancën e disa vendeve rurale nuk ka mjek e madje as infermiere, desha t'ju them se në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2000/45 mbi pushtetin lokal dhe në bazë të memorandumit të mirëkuptimit të nëntorit 2001 – aspekti organizativ i kujdesit primar është në kompetencat e drejtorëve shëndetësor komunal. Mirëpo kjo nuk do të thotë se ne si Ministri e Shëndetësisë nuk duhet të kujdesemi apo nuk duhet të mirremi me këtë çështje. Së pari t'ju them se kjo është si pasojë e dhënies së specializimeve të pakontrolluara në të kaluarën. Proporcioni mjek – banor nuk është i favorshëm gjë e cila ka ndikim të madh në çështjen për të cilën jeni të interesuar.

Çka jemi duke bërë ne si Ministri në këtë aspekt? Këto ditë është nënshkruar udhëzimi administrativ lidhur me specializimet ku parashihet që çdo mjek pas kryerjes së fakultetit është i obliguar të punojës ë paku një vit, pas stazhit i cili po ashtu zgjatë një vit në kujdesin parësor, që është e rëndësisë së dyfishtë,

sepse në njërin anë mbulohet shërbimi nëpër ambulanta dhe punktet shëndetësore, ndërsa në anën tjetër kjo ndikon në aftësimin sa më të mirë të mjekve të rinj.

Kur është për ambulantën në Livagjë, ju them se këto ditë është bërë hapja e saj ku një infermier do të jetë çdo ditë, ndërsa mjeku do të punojë tri herë në javë. Ju falemnderit.

BASHKËKRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Ju falemnderit zonja Mumxhiu. Së pari deputeti Ramadan Kelmendi, pastaj zoti Ismajl Kurteshi.

RAMADAN KELMENDI:

I nderuari kryesues, e nderuar ministreshë, të nderuar deputetë,

E vlerësoj shumë të arsyeshme dhe mjaft me rëndësi dhënien e përgjigjes së Ministrisë së Shëndetësisë për gjendjen shëndetësore në regjionin e Mitrovicës. Por është e pakuptueshme dhe e paarsyeshme që pyetja e parashtruar me shkrim dhe arsyetim nuk iu është dorëzuar deputetëve sot për ta parë përmbajtjen e saj dhe qëllimin e pyetjes. Megjithkëtë, natyrisht se është obligim ligjor që qytetarët të gëzojnë mbrojtjen shëndetësore adekuate, por mjerisht kjo nuk ndodh në Mitrovicë në tërësi në të gjitha nivelet shëndetësore. Dhe, fatkeqësisht, kjo në Mitrovicë është edhe më e rëndë dhe është shumë e panjohur me të. Gjendja e mbrojtjes shëndetësore është shumë e rëndë dhe mjaft e ndërlikuar në procesin e realizimit të saj. Mitrovica, nga një qendër regjionale spitalore, është shndërruar në një qytet ambulantor. Mitrovica nga një qendër industriale është shndërruar në qytet skamnor – me 87.72% të papunëve të cilët nuk mund të kërkojnë as të drejtën më elementare të mbrojtjes shëndetësore për shkak të participimit dhe formave tjera. Dhe, është shumë e vërtetë se tani qytetarët e Mitrovicës dhe rajonit të saj po përballohen me - përveç shumë probleme politike, të cilat iu janë të njohur pjesërisht dhe jo tërësisht - edhe me mbrojtjen shëndetësore. Dhe konkretisht, me bartjen e repartit të kirurgjisë dhe të shërbimit intensiv nga Spitali i Mitrovicës në atë të Vushtrrisë – 141.852 banorë të Mitrovicës...

BASHKËKRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Ramadan, të lutem e ke bërë pyetjen, e ke përgjegjen. Të lutem përfundoje.

RAMADAN KELMENDI:

Ju lutem, duhet të njihet populli dhe deputetët me gjendjen që është në Mitrovicë së paku...

...dhe 86.000 të Skenderajt kanë mbetur pa mrbojtjen shëndetësore, nga se çdo ditë prej orës 13 dhe çdo ditë jopune – të shtuneve e të dieleve atje nuk mund të ofrohet kurrfarë ndihme. Kanë shkue në Vushtrri për të fjetë dhe për të pushuar, sepse atje mungon transfuzioni i gjakut, mungon anastelogu, mungojnë edhe instrumentet...

BASHKËKRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Ramadan, të lutem parashtroi elementet e nevojshme. Elementet se a je i kënaqur a s'je i kënaqur?

RAMADAN KELMENDI:

Qe elementet e nevojshme. Profesor edhe dy fjalë. Përtej urës është Spitali regional, 1500 metra në veri të urës i cili është i okupuar nga serbët dhe kemi ndarë mjete ne si Kuvend. Ku e kemi ndërgjegjen? Për kend i kemi ndarë? Ju lutem, edhe me ju polemizojmë! Dhe 14 mijë metra katror hapësirë spitalore nuk shfrytëzohen; nuk shfrytëzohen 760 shtretër; nuk shfrytëzohen 6 salla të operacionit; nuk shfrytëzohen 9 dhoma të kujdestarisë intensive. Dhe, ja kjo është gjendja.

Ju lutem prej 27 shtatorit në Spitalin e Mitrovicës qendror është heqë flamuri i UNMIK-ut dhe valonflamuri i Serbisë dhe atje s'ka qasje asnjë shqiptar, asnjë rom, asnjë hashkali. Vetëm serbët... Dhe, të gjitha këto probleme janë të mëdha.

Fundi i fundit, ka për obligim Ministria që t'i merrë të gjitha masat: politike, administrative dhe juridike që t'i kthejë punëtorët e shëndetësisë në spitalin e tyre të cilin ne po e financojmë dhe qytetarëve t'iu mundësojë mbrojtje. Vërtetë ky problem është i hapur. Unë po shoh se as këtu s'ekziston interesimi dhe po kam pengesë t'i shtroj pyetjet.

Sido që të jetë, unë e kuptoj Ministrinë se ka probleme, por Mitrovica po ballafaqohet me shumë probleme, e një ndër to edhe shëndetësia. Mitrovica është shndërruar në një qytet skamnorësh dhe qytet të të sëmuresh, pa mundësi për mbrojtjen e të drejtave. Spitali në Vushtrri është dhuratë e Emirateve Arabe

dhe dhurata nuk mund të administrohiet si e mendojmë ne bash leht dhe me të drejtë. Ju falemnderit.

BASHKËKRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Ju falemnderit. Unë mendoj se duhet t'i keni parasysh edhe këto elemente. Ia përcjellni edhe Ministrisë dhe asgjë më tepër.

E ka fjalën Ismajl Kurteshi.

ISMAJL KURTESHI:

Së pari e falënderoj ministreshën për përgjegjen në pyetjen, të cilën unë e kam bërë më 13 nëntor, do të thotë para dy muajve dhe meqë pyetja nuk iu është shpërndarë deputetëve – do ta lexojë, se është shumë e shkurtër.

Në shumë fshatra të Kosovës, edhe pse ekzistojnë ambulanta atje, mjekët shkojnë një ose dy herë në javë. Madje ka raste kur nuk shkojnë fare, si në rastin e fshatit Livoç i Epërm në komunën e Gjilanit – 3 kilometra larg qytetit ku USAID-i e ka ndërtuar ambulancën e re në qershorin e vitit të kaluar, e cila është përruar dhe që edhe tani pas pesë muajve nuk ka filluar të punojë për shkak, siç thuhet – të mungesës së mjekëve dhe infermierëve. Konsideroj se problemet e kësaj natyre kërkojnë edhe angazhimin e Ministrisë tuaj.

Unë e di që shëndetësia primare i takon komunave, por mendoj se Ministria nuk mund të jetë indiferente në këto raste, të cilat janë shumë të ndieshme, prandaj konsideroj se do të duhej të intervenonte në të gjitha këto raste.

Ambulanca ka ndejt e re e mbyllur gjashtë muaj dhe është hapur më 5 janar, para dhjetë dite, që do të thotë është një neglizhencë e madhe.

Probleme në shëndetësi ka edhe me specialistët, të cilët në pjesë të madhe të orarit të punës e kalojnë në ordianca private, prandaj ju kisha lutur që Ministria juaj të kujdeset më shumë dhe çështja e shëndetit është vërtetë çështje për të cilën do të duhej të kemi të gjithë deputetët durim dhe Ministria juaj më shumë punë në këtë drejtim. Ju falemnderit.

BASHKËKRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Ju falemnderit. Vazhdojmë punën. Urdhëro Oliver.

OLIVER IVANOVIĆ:

Ja moram da kažem predsedavajući da vi kršite Poslovník. Da o pitanju koje je podneto ministru može da se izjasni samo onaj ministar, a onaj koji je podneo pitanje može da ima primedbu ako je nezadovoljan. Ne otvara se debata o ovome. Uz uvažavanje teme koju su kolege pomenuli, znači ta tema može da bude tema za dnevni red nekom prilikom kada se ona usvoji i kada se na dnevni red stavi. Da samo skratimo i da privodimo kraju o vo, jer ima verovatno još pitanja.

BASHKËKRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Jo, jo, të lutem. Pyetje tjera nuk ka.

Ju lutem, pyetje tjera nga Sekretaria nuk ka të përgatitura. Nëse deputetët kanë shtruar pyetje për përgjigje nga ministritë përkatësisht Qeveria ato shkojnë në procedurë të rregullt. Deri tash nuk kemi përgjigje të drejtpërdrejta. Unë do ta propozoj rendin e ditës të paraparë nga Kryesia dhe do të bisedojmë.

Kalojmë në pikën e pestë të rendit të ditës – Propozimi i rendit të ditës për seancën e ardhshme më 22 janar:

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Odën Ekonomike të Kosovës;
2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tregti me naftë dhe derivatet e saja; dhe
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kinematografinë (i cili ka ardhë në procedurë normale dhe do të jetë para Kuvendit).

A pajtoheni me këtë rend dite, apo keni diç për të shtuar? Urdhëro Tomë, të dëgjojmë.

TOMË HAJDARAJ:

Të falemnderit zoti kryesues. Meqenëse ligji mbi materialin fidanor ka ardhë në procedurë të Kuvendit, kisha me ju lutur që në rendin e ditës për leximin e parë për javën e ardhshme të hyjë ky ligj, sepse e ka afatin optimal dhe i cili duhet të aprovohet dhe, në të kundërtën do të humbim edhe në kualitet të importit të fidaneve qofshin ato të pemëve, vreshtave dhe të pyjeve. Kisha pra me ju lutur që të futet në rend dite ky ligj.

BASHKËKRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Mirë, Kryesia do të shiqojë nëse është në procedura normale dhe do ta ketë parasysh propozimin. Lirak urdhëroni.

LIRAK ÇELAJ:

I nderuar kryesues, të nderuar kolegë,

Unë propozoj që, në qoftë se jo në mbledhjen e ardhshme, së paku në mbledhjen e radhës pas asaj të vjen në rend dite çështja e imunitetit të deputetëve dhe sjelljes së disa policëve të papërgjegjshëm ndaj deputetëve dhe sigurisht edhe ndaj qytetarëve.

Këtë po e them nga përvoja që kam patur unë. Natyrisht shumëherë kam pasë përvojë të mirë me polic që janë sjellë shumë mirë, kanë qenë korrekt – padyshim janë me shumicë, por disa policë të cilët si duket e kanë keqkuptuar detyrën e tyre dhe si model e kanë sjelljen e policëve të Serbisë që kanë qenë përpara këtu. Shpesh na ka ndodhë në Kuvend, unë po i them këtu disa raste që më kanë ndodhur mua, por edhe me shumicën e deputetëve kur kam bisedue – shumica e deputetëve kanë eksperiencë të ngjashme me disa policë, po them disa individë. Më ka ndodhur kur kam hyrë në Kuvend, polici është sjellë aq keq me mua dhe më ka urdhëruar që ta vari ajdi-kartën – kartelën e identifikimit. Ju lutem, çka jemi ne këtu? Do të thotë është dashur që të ketë njëfarë rregulle dhe të mos urdhërohem... Mu ka kërcnue se do t'më qet jashtë në qoftë se nuk e vari kartelën e ajdisë.

Ose, një rast që ka qenë në Gjakovë, më ka ndodhur më 28 dhjetor. Në momentin kur i kam tregue policit që jam deputet, ai pikërisht në atë moment ka vendosur t'më dënoj. Tha – deputet je? Parkou këtu, tash të tregoj unë. Dhe kur i kam thënë se nuk do të duhej të silleni si arrogant, ai si duket s'e kuptonte çka është fjala arrogant, m'u kërcnue se do t'më arrestoj pse i thash arrogant.

Kisha dashur të dij, edhe me qytetarë të thjeshtë të debatojmë për policinë, por edhe neve si deputetë autoriteti të na ruhet disi.

BASHKËKRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Mirë, ju falemnderit. Do të përcillet kjo.

FATMIR REXHEPI:

I nderuar kryesues, të nderuar deputetë,

Një njoftim lidhur me propozimin për pikën e parë – rreth ligjit për Odën Ekonomike që është vë në rend dite për javën e ardhshme. Pas shqyrtimit, gjegjësisht dëgjimit publik që ka patur Komisioni për ekonomi dhe financa dhe pas interesimit të jashtëzakonshëm që ka treguar komuniteti i biznesit privat në Kosovë, ne nuk do të mundemi, do të thotë me ecurinë që e kemi përpara ta përgatisim për javën e ardhshme. Kështu që mendojmë dhe ju njoftojmë që ky ligj të mos vëhet në rend dite por të shtyhet për një seancë tjetër, pasi t'i bëjmë ato amendamente dhe të jemi të gatshëm për aprovimin e atij ligji. Ju falemnderit.

BASHKËKRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Mirë, ju falemnderit. Kryesia do të ketë parasysh edhe këtë propozim tuajin dhe do të shohim si do të veprojmë më vonë. Për rendin e ditës ke diçka Edita?

EDITA TAHIRI:

I nderuar kryesues, të nderuar deputetë,

Së pari desha të njoftoj për vështirësitë e atyre që ulen në pjesën e prapme të kësaj salle. Më duket, përveç që s'e kemi privilegjë të ulemi mbrapa, e dyta jemi të injoruar se fare nuk jeni duke na shikuar. Unë kam bërë ushtrime fizike, me thënë që nja 10-15 minuta duke ngritur dorën. Nuk vlenë vetëm për ju, zoti kryesues. Kjo është kronike. Pra, mos e merrni vetëm personalisht.

Kam dalë këtu që të propozoj një rend dite, të cilin e kam propozuar gjashtë muaj përpara por që nuk ka dalë në rend dite. Është fjala për gjendjen në telekomunikacionin e Kosovës dhe në kohën kur unë e kam propozuar – kjo fushë e rëndësishme e ekonomisë së Kosovës ka qenë duke u ballafaquar me korrupsionin dhe tani kjo fushë ballafaqohet edhe me fenomenin e thellimit të kaosit në tregun telekomunikues. Ne, natyrisht, të gjithë kemi qenë të gëzuar që u votua Ligji këtu, u nënshkrua dhe hyri në fuqi në maj të vitit të kaluar dhe tani janë gjashtë muaj e më shumë... Në vend se të vendoset rregull në tregun e telekomunikacionit, ne kemi thellim apo eskalim të gjendjes.

Prandaj, kërkoj që kjo të jetë çështje urgjente për rendin e ditës.

Kam pas e dhe një pyetje, por më duket se pyetjet duhet me i bënë me shkrim, prandaj nuk do ta bëj tani. Ju falemnderit.

BASHKËKRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Ju falemnderit. Edhe propozimi juaj do të përcillet. Urdhëroni, për rendin e ditës?

LJUBOMIR STANOJKOVIĆ:

Poštovane kolege, sutra je 16. januar – dan kada počinje tender za treću grupu preduzeća koja će da se privatizuju. S obzirom na različite kontraverze, po mom mišljenju haosa, a ne – na srpskom postoji jedna druga reč a to je pljačka koja se odvija oko privatizacije – mislim da je ovo nešto veoma interesantno za sve nas i da bi tačka o privatizaciji odnosno da još jednom prodiskutujemo o regulativi vezano za privatizaciju mislim da bi bilo potrebno barem na sledećoj sednici ako nismo uspeali da to na ovoj današnjoj. Hvala.

BASHKËKRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Falemnderit. Edhe ky propozim do t'i përcillet Kryesisë. Urdhëro Xhavit.

XHAVIT HALITI:

S'domend që të gjitha propozimet dhe kërkesat do të duhej të mirreshin në shqytim nga ana e Kryesisë për t'u futur në rend të ditës dhe në veçanti çështjet që i ngrii Edita Tahiri.

Por, unë desha të ndalem tek një çështje tjetër, për të cilën mendoj se ky Kuvend do të duhej ta thirrë në interpelancë shefin e policisë së UNMIK-ut dhe normalisht të kërkojë në rrugë ligjore, edhe pse s'është në kompetencë e jona me marrë në pyetje këtu, që t'na sqarojë, një:

Lidhur me akuzën e servuar që ia kanë bërë zotit Hollkeri në prak të fillimit të detyrës së tij "se shqiptarët kanë v rarrë fëmijë se rbë në Kosovë". Në qoftë se Kosova është akuzuar për këtë çështje dhe nuk janë zbuluar vrasësit, atëherë mendoj se ata që ia kanë servu informatën do të duhej të na kërkonin falje të gjithë kosovarëve.

Dhe, kërkoj që kërkesat e zotit Çelaj në këtë rast për sjelljet e pahijshme të policëve, po e potencoj, se më duket mbeti borxh – të SHPK, të cilët shumëherë sillen si të jenë kauboj e jo policë të cilët kanë për obligim t'u shërbejnë qytetarëve të Kosovës – të vijjnë në shqyrtim në Kuvend dhe përgjegjësit e tyre ta diskutojnë ose marrin masa ndaj sjelljeve të tilla. Ju falemnderit.

BASHKËKRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Ju falemnderit. Dëgjuat propozimin bazë të Kryesisë dhe ... Për çfarë dëshiron fjalën? Urdhëro.

RANDJEL NOJKIĆ:

Kolegenice i kolege, Radno predsedništvo,

Meni je žao zaista da stalno se stvaraju odredjeni problemi o tome da li se poštuje jedan ili drugi poslovnik o radu Skupštine ili vrlo često krši se jedan i drugi. I na taj način, zaista se čini jedna teška – teška diskriminacija. Mislím da ovo nema smisla, da ja kao član Komisije....

(Reagim i bashkëkryesuesit: Ju lutem për rendin e ditës.)

(Ndërprerje në ton)

RANDJEL NOJKIĆ:

Nemojte da me... Pa vidim ja da vi vršite diskriminaciju. To nije sporno, razumete...

BASHKËKRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Ju lutem, për rendin e ditës urdhëroni. Ai është vlerësim i juaj.

RANDJEL NOJKIĆ:

... Ali, dozvolite mi da kažem isto kao što svi iznose ovde svoja ovde lične probleme. Mi smo ovde čuli lepo da su ljudi izneli svoje probleme zato što su

imali sa policajcima i ne znam gde probleme, a sada mi u institucijama sistema imamo probleme ali vi to nećete da čujete....

BASHKËKRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Ju lutem, për rendin e ditës ose përndryshe e keni mikrofonin e ç'kyçur.

RANDJEL NOJKIĆ:

Da, hoću, govoriću o dnevnom redu. Tačno je, ali hoću da navedem i ovaj primer. Ja na to imam primam kao poslanik i molim vas proučite Poslovník o radu i molim vas, još nešto da vam kažem: važeći Poslovník je privremeni poslovník. Ovaj Poslovník SPGS nije odobrio...

(Ndërprerje në ton)

BASHKËKRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Ju lutem, a doni për rendin e ditës, a keni ndonje propozim?

RANDJEL NOJKIĆ:

Pa, pustite mi da objasnim zbog čega tražim dnevni red. Ja imam pravo da objasnim to brate. Vi nećete da mi dozvolite da objasnim. Vi vidite da ima mnogo problema kada je u pitanju Poslanička grupa Koalicije «Povratak». Ignorišete te probleme. Ja tražim da se pod hitno izvrši analiza, jer je ovode optužena Koalicija «Povratak» da vrši destrukciju i da zbog toga zakoni nisu..., nije potpisao SPGS, ne uzimajući u obzir da ti zakoni nisu potpisani zato što su ...

(Ndërprerje në ton)

BASHKËKRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Urdhëroni për rendin e ditës, ju lutem përmbliidheni.

RANDJEL NOJKIĆ:

Pa govorim o dnevnom redu. Tražim da se na dnevnom redu postavi ta tačka, molim vas. Je li čujete šta ja govorim. Ja upravo govorim o dnevnom redu. Ja

tražim da se na dnevnom redu postavi analiza rada i funkcionisanje ove institucije. To je prva stvar.

BASHKËKRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Po hajt urdhëro. Po mirë, urdhëroni.

RANDJEL NOJKIĆ:

Predlažem dalje da se već na drugoj..., na sledećoj sednici postavi pitanje bezbednosti situacije kada je u pitanju Srpska zajednica. Vi znate šta se desilo pre par dana u Lipljanu i molim vas to zaslužuje, to zaslužuje veoma – veoma ozbiljnu analizu, veoma ozbiljnu diskusiju i molim vas da se ova institucija prema takvim pojavama odredi. Ne mogu da se neke stvari, razumete kada se dese kod Albanaca - da se odmah na prvoj sednici izanaliziraju bez obzira da li je procedura ispoštovana ili nije ispoštovana, a mogu jednu zajednicu ovde da ubijaju, da diskriminišu, da rade šta god hoće, i ne sme da se čuje nijedna red. To ne sme. Prema tome, ja zahtevam da se ovo pod hitno stavi na dnevnom redu. Hvala.

BASHKËKRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Ju lutem, të përfundojmë. Patëm parasysh edhe propozimet dhe propozimin bazë që është dhënë nga Kryesia e Kuvendit. Propozimet e ndërkohshme le të përcillen plus me shkrim Kryesisë së Kuvendit dhe të shohim në procedurë normale t'i procedojmë.

A pajtoheni që ky rend dite të jetë për seancën e ardhshme?

Kush është për? Ju falemnderit.

Konstatoj se me kaç mbledhja e sotme përfundoi.

Seanca përfundoi punën në orën 12,25.

E transkriptoi RT(fq:1-32)Zyra E-04, tel. 038-211-860